

VENDIM
Nr. 45, datë 29.1.2014

**PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-
NDËRMARRJEVE BUJQËSORE DHE ISH-INSTITUCIONEVE KËRKIMORE-SHKENCORE
TË KËSAJ MINISTRIE, AKTUALISHT NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15, shkronja “c” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore me sipërfaqe 18 076 (tetëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) ha të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, e cila aktualisht është në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Sipërfaqet e tokave bujqësore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të administrohen sipas ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat” dhe vendimit nr. 460, datë 22.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

3. Shkronja “c” e pikës 1 të vendimit nr. 567, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për caktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik”; vendimi nr. 868, datë 18.6.2008 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”; pika 1 e vendimit nr. 459, datë 22.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në fondin e kompensimit fizik të krijuar nga fondi i tokës bujqësore”; urdhri nr. 265, datë 1.10.2002 i Kryeministrit “Për evidentimin dhe ndërprerjen e procedurave të tjetërsimit ose dhënies me qira të pronës shtetërore, tokë bujqësore, pyjore livadhe dhe kullota”, dhe urdhri nr. 287, datë 20.12.2006 i Kryeministrit “Për evidentimin dhe ndërprerjen e procedurave të tjetërsimit të pronës shtetërore, tokë bujqësore, livadhe dhe kullota”, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

